



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 21.07.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.07.2022, të parashtruar nga Grupi i Operatorve ekonomik N.T.Sh., Marash - Shped Sh.p.k” & “Company Zuka Commerce” sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi i nyjeve sanitare në shkollat e Gjakovës “, Nr. i prokurimit- 632-22-4727-5-2-1, nxjerr:

### V E N D I M

1. **Aprovohet** si pjesërisht e bazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorve ekonomik N.T.Sh., Marash - Shped Sh.p.k” & “Company Zuka Commerce” sh.p.k., e dt.18.07.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi i nyjeve sanitare në shkollat e Gjakovës “, Nr. i prokurimit- 632-22-4727-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-027-521, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, te AK –së, të datës 13.07.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.

2. **Anulohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë 13.07.2022;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që lëndën ta kthej në rivlerësim;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

## Ar sy e t i m

Me dt.18.07.2022, Grupi i Operatorve ekonomik N.T.Sh.,Marash - Shped Sh.p.k" & "Company Zuka Commerce" sh.p.k., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi i nyjeve sanitare në shkollat e Gjakovës " , Nr. i prokurimit- 632-22-4727-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-027-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 21.07.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit të Kërkesës për rishqyrtim të Grupit të Operatorëve ekonomik N.T.Sh.Marash - Shped Sh.p.k" & "Company Zuka Commerce" sh.p.k., të dt.18.07.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi i nyjeve sanitare në shkollat e Gjakovës " , Nr. i prokurimit- 632-22-4727-5-2-1 dhe Nr. i brendshëm-632-22-027-521, Autoriteti kontraktues, konstaton se pretendimet e Grupit të Operatorëve në fjalë, janë pjesërisht të bazuara, prandaj vendos që të lëndën ta kthejë në rivlerësim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

### Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Faton Gutaj  
  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës